

**Fleta e të dhënave të produktit**  
Botimi 07/07/2014 (v1)  
Kodi: 05.05.040  
Nr. i identifikimit: 024761000010004000  
Sika® Primer-215

## Sika® Primer-215

### Prajmer për nënshtresa poroze dhe plastike

**Përshkrimi i produktit** Sika® Primer-215 është një lëng i tejdukshëm, i verdhë i hapur dhe me viskozitet të ulët që thahet në reaksion me lagështinë atmosferike. Përdoret për lyerje me prajmer të nënshtresa plastike, druri dhe materialeve të tjera poroze përpara aplikimit të produkteve Sikaflex® dhe SikaBond®.

**Përdorime** Është i përshtatshëm për aplikim mbi nënshtresat e mëposhtme:

- Plastike
- GRP
- Rrëshire epokside
- PVC
- ABS
- Druri

**Karakteristika / Avantazhe**

- Aplikim i lehtë
- Kohë e shkurtër tharjeje

#### Të dhënat e produktit

**Ngjyra** Lëng i verdhë

**Kushtet e magazinimit / Jetëgjatësia** 12 muaj nga data e prodhimit nëse magazinohet saktë në konteinerët origjinalë të padëmtuar, të pahapur dhe të vulosur në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C.

**Ambalazhi** shishe 250 ml, 6 shishe/ kuti

#### Të dhëna teknike

**Baza kimike** Përbërje 1 komponenti rrëshire epokside me bazë tretësi

**Dendësia** ~ 1,0 kg/l (CQP<sup>1</sup>) 006-3, ISO 2811-1)

**Përmbajtja solide** ~ 34%

**Koha e tharjes<sup>2</sup>**  
≥ 15°C (60°F): 30 minuta  
< 15°C (60°F): 60 minuta  
Maksimumi: 24 orë

<sup>1</sup>) Sika Corporate Quality Procedure

<sup>2</sup>) Nën kushte të veçanta, koha e tharjes mund të ndryshojë

#### Detaje aplikimi

**Metoda e aplikimit / Mjetet** Aplikoni Sika® Primer-215 mbi nënshtresë me një furçë ose rul të pastër. Duhet të aplikohet vetëm një herë. Mbylleni mirë konteinerin menjëherë pas çdo përdorimi.

**Përgatitja e nënshtresës** Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të thata dhe pa vaj, graso dhe pluhur, pjesë të lira ose të shkrifëta. Korja e çimentos duhet të hiqet.



<b>Temperatura e aplikimit</b>	+5°C deri në +40°C Temperatura ideale e aplikimit: Nga +15°C deri në +25°C Temperatura e nënshtresës në aplikim duhet të jetë min. 3°C mbi pikën e vesës!	
<b>Konsumimi / Doza</b>	Prurja për litër ~ 5 m <sup>2</sup> mbi nënshtresa poroze ~ 7 m <sup>2</sup> mbi nënshtresa joporoze	Metër linear fuge për litër ~ 220 m mbi nënshtresa poroze ~ 300 m mbi nënshtresa joporoze
<b>Shënime mbi aplikimin / Kufizime</b>	Sika® Primer-215 duhet të përdoret brenda një muaji pas hapjes së konteinerit. Hidhni produktin i cili mund të jetë kthyer në xhel ose është ndarë.  Prajmerat përdoren për përmirësimin e ndërkapjes. Ato nuk zëvendësojnë pastrimin e duhur të sipërfaqes dhe as nuk përmirësojnë rezistencën e saj. Prajmerat përmirësojnë performancën afatgjatë të fugës së vulosur.	
<b>Dokumenta shtesë në dispozicion</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Fleta e të dhënave të sigurisë (Safety Data Sheet, SDS)</li> <li>■ Tabelë Trajtimi Paraprak, Vulosje &amp; Ngjitje</li> <li>■ Method Statement për Vulosjen e fugave</li> <li>■ Method Statement për Mirëmbajtjen, pastrimin dhe rinovimin e fugave</li> </ul>	
<b>Baza e vlerave të matshme</b>	Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.	
<b>Kufizime lokale</b>	Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për përshkrimin e saktë të fushave të aplikimit.	
<b>Informacione mbi shëndetin dhe sigurinë</b>	Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit të sigurt, maganizimit dhe asgjësimit të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen botimit më të fundit të fletës me të dhënat e sigurisë (Safety Data Sheet, SDS), e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike, etj. rreth sigurisë gjatë përdorimit të produktit.	
<b>Shënime ligjore</b>	Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të SIKA-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e SIKA-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. SIKA ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.	



**Sika Albania SHPK**  
Rruga Ibrahim Rugova,  
Sky Tower, Building no. 5,  
9<sup>th</sup> floor, Office 91,  
Tirana, Albania.

Tel.: +355 4 454 0070  
Email: info@al.sika.com  
alb.sika.com